



**Save the Children**



# **MODELI I SHËRBIMEVE TË BAZUARA NË KOMUNITET PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

*Prishtinë, Dhjetor 2018*



**Modeli i Shërbimeve të Bazuara  
në Komunitet për Fëmijët me Aftësi  
të Kufizuara**

*Blerta Perolli Shehu, Konsultente*

*Prishtinë, Dhjetor 2018*

## Qëllimi

Qëllimi i këtij aktiviteti është të theksojë praktikat më të mira të zbatuara në Qendrat HANDIKOS të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi (QRBB), që funksionojnë në komunat Ferizaj dhe Gjakovë, të financuara nga donatori Margaret Cargill Philantropy (MACP) dhe implementuara në partneritet me Save the Children International në Kosovë. Ky dokumentim mbulon arsyetimin dhe përshkrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve, përshkrimet për përfituesit, stafin, nevojat për ngritjen e kapaciteteve për këto shërbime, aspektet e mbrojtjes së fëmijëve që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve, politikat dhe procedurat e qendrës dhe funksionet e përgjithshme. Ai gjithashtu ofron analizimin e kostos operacionale për ofrimin e shërbimeve nga qendrat me bazë në bashkësi. Qëllimi përfundimtar i dokumentimit të modelit ekzistues, me theks në rëndësinë dhe arsyetimin e këtyre shërbimeve, është që të sigurojë financim të qëndrueshëm.

## Tabela e Përmbajtjes

Arsyeshmëria për Shërbimet e Bazuara në Komunitet për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara.....	4
Shërbimet e bazuara në Komunitet për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara.....	7
Përfituesit e Shërbimeve të bazuara në Komunitet.....	11
Punonjësit e Shërbimeve të bazuara në Komunitet .....	13
Puna me përfituesit.....	22
Dokumentimi i procesit të menaxhimit të rastit.....	24
Indikatorët e suksesit.....	26
Mbrojtja e Fëmijëve .....	28
Parimet dhe politikat e Qendrës RBB.....	29
Informimi dhe promovimi i shërbimeve.....	30
Objektet e Qendrës RBB.....	31
Hapat e inicimit të një Qendre RBB.....	34
Praktikat rajonale në ofrimin e shërbimeve të bazuara në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara.....	34
Analiza preliminare e shpenzimeve për qëndrueshmëri të financimit për këto shërbime .....	44
Strategjitë e mbledhjes së fondeve.....	46
Shtojcë I: Korniza e Shërbimeve dhe Standardet Minimale të Cilësisë së Shërbimeve Sociale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara në Qendrat e Kujdesit Ditor .....	48
Referencat.....	60

# Arsyeshmëria për Shërbimet e Bazuara në Komunitet për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (UNCRC) dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRPD) qartë theksojnë se të gjithë fëmijët duhet të realizojnë të drejtat e tyre themelore. Të gjithë fëmijët duhet të jenë anëtarë të plotë të shoqërisë. Konventat theksojnë se çdo fëmijë është një individ unik - i cili ka të drejtën në jetë, në ushqim, në respektim dhe të jetë i konsultuar në çështjet që kanë të bëjnë me të. Konventat argumentojnë për promovimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe jo vetëm integrimin e thjeshtë.

UNCRC është e shkrirë në Kushtetutën e Kosovës dhe thekson që ndihma duhet të ofrohet pa pagesë, për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë qasje efektive dhe të jenë përfitues të arsimit, shërbimeve shëndetësore, shërbimeve rehabilituese, përgatitjes për punësim dhe mundësive të rekreacionit në mënyrë të favorshme për arritjen e integrit të plotë social dhe zhvillimin individual të fëmijës, përfshirë zhvillimin e tij kulturor dhe shpirtëror.

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë një nga grupet më të marginalizuara, përballë stigmës, diskriminimit dhe ndarjes në komunitetet e tyre. Ata shpesh janë të privuar nga arsimi dhe të drejtat dhe shërbimet e tjera themelore dhe janë dukshëm më të cënueshëm sesa bashkëmoshatarët e tyre ndaj dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit. Analizat paraprake në këtë drejtim kanë konstatuar se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë mungesë të theksuar të qasjes në alternativa cilësore të bazuara në komunitet. Analizat dhe vlerësimet e kryera në Kosovë nga Save the Children dhe organizatat tjera dëshmojnë për mungesa të theksuara të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, mungesë të profesionistëve të trajnuar për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe shpërndarje e pamjaftueshme të burimeve financiare shtetërore për këtë qështje (Save the Children, 2018). Pa shërbime lokale adekuate dhe të përshtatshme, shumë familje ndihen të paafte

për të mbështetur zhvillimin psiko-social të fëmijëve të tyre, rehabilitimin fizik në shtëpi dhe përfshirjen në shkolla dhe në jetën e komunitetit (Handikos, 2018)

Sipas të dhënave nga Organizata Handikos (2018), vlerësohet se ka rreth 20,000-40,000 fëmijë me aftësi të kufizuara në Kosovë. Mungesa e të dhënave të sakta në dispozicion pasqyron si natyrën 'e padukshme' të aftësisë së kufizuar, poashtu dhe ndryshimin në përkufizimin, klasifikimin dhe kuptimin e të drejtave dhe nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Është dokumentuar mirë se fëmijët vuajnë nga vështirësi të konsiderueshme, diskriminim dhe shkelje të të drejtave themelore të njeriut në Kosovë, si drejtpërdrejt (barriera socio-kulturore dhe qëndrimore) ashtu edhe tërthorazi (pengesat mjedisore dhe institucionale, përfshirë zbatimin joadekuat të politikave dhe ligjeve duke përfshirë financimin). Mbi 25% e fëmijëve me aftësi të kufizuara raportojnë se përjetojnë diskriminim, stigmën sociale, përjashtimin, aktet e dhunës dhe abuzimet - më të mëdha në zonat urbane dhe në mesin e atyre me vështirësi intelektuale dhe psikologjike (Handikos, 2018).

Fëmijët me aftësi të kufizuara shpesh herë mund të përjetojnë izolim, abuzim dhe neglizhencë, qoftë për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme të familjarëve apo burimeve të pamjaftueshme. Qëndrimet negative shoqërore të vendosura thellë në porët e shoqërisë, ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara duke përfshirë pritjet e ulëta, frikën, injorancën, bëmirësinë dhe keqardhjen e keqdrejtuar, kufizimet fizike dhe jofizike të ndërtesave (duke përfshirë shëndetësinë dhe shkollat) dhe sistemet e paarritshme të transportit rezultojnë në vonesa në qasjen e shërbimeve për identifikim dhe ndërhyrje të hershme.

Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë nevoja të dokumentuara mirë në Kosovë. Një nga nevojat më urgjente është tejkalimi i qasjes mbizotëruese bëmirëse, e cila i sheh fëmijët me aftësi të kufizuara si "pranues pasivë të kujdesit" - evident në të gjithë sektorët në Kosovë (O'Toole, 2013). Në shoqërinë Kosovare, fëmijët me aftësi të kufizuara tentojnë të perceptohen në kuptim të vështirësive të tyre dhe jo të theksojnë potencialin e tyre për të kontribuar

dhe pasuruar shoqërinë. Prandaj, qasja bëmirëse - megjithatë me qëllim të mirë - mund të forcojë problemet me të cilat përballet fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të kufizojë lëvizshmërinë e tyre sociale. Ata mbeten si të huaj në shoqëri.

Pavarësisht disa përmirësimeve, ngjashëm me vendet e tjera në rajon, Kosova vazhdon të përballet me mangësi në aspektin e disponueshmërisë, cilësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve me bazë në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike dhe intelektuale. Një analizë e bërë nga Save the Children (Analizë e situatës së të drejtave të fëmijëve - CRSA) për rajonin ka identifikuar dobësi në shërbimet që synojnë fëmijët me aftësi të kufizuara. Analiza jo vetëm që ka identifikuar praninë e shërbimeve direkte të pamjaftueshme dhe të cilësisë së ulët për fëmijët me aftësi të kufizuara, por ka gjetur po ashtu se ofruesit e shërbimeve përballet me mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe me struktura dhe sisteme jo të rregullta të mbikëqyrjes profesionale. Analiza po ashtu ka identifikuar sisteme të kufizuara ose mungesë të sistemeve për monitorimin e pavarur dhe demonstrimin e cilësisë së shërbimeve dhe rezultateve për përdoruesit e shërbimeve dhe ka pranuar se ka sisteme dhe shërbime jo adekuate të mbështetjes për familjet, sidomos për ato në rrethana të vështira.

Këto dobësi kanë ndikim negativ tek përdoruesit e shërbimeve. Disponueshmëria e kufizuar e shërbimeve sociale të ofruara nga ofruesit e shërbimeve sociale me bazë në komunitet mund t'i lë pa ndihmë një numër të konsiderueshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara, dhe kjo mund të ndikojë në mirëqenien e tyre në afat të gjatë. Në të njëjtën mënyrë, mungesa e shërbimeve të specializuara ose shërbimet sociale cilësore të kufizuara për fëmijët në nevojë mund të ketë efekte të dëmshme, duke i lënë të papërmbushura dhe të pa adresuara nevojat e tyre. Ngjashëm, ofruesit e shërbimeve të komunitetit që nuk kanë sisteme të duhura të menaxhimit të brendshëm, mbikëqyrje profesionale të shërbimeve dhe monitorim të ndikimeve të arritura nuk do të jenë në gjendje t'i modernizojnë vazhdimisht shërbimet e tyre për ta rritur efektivitetin dhe efikasitetin. Në anën tjetër, kur prindërit nuk janë të informuar

apo nuk kanë udhëzime specifike për mënyrën e asistimit të fëmijëve të tyre, kontributi i tyre në arritjen e potencialit të plotë të zhvillimit të fëmijëve të tyre mund të jetë i kufizuar.

Për të adresuar disa nga dobësitë e paraqitura më sipër, Save the Children ka pranuar një financim të pakursyer nga Fondacioni Margaret A. Cargill Philanthropy (MACP) për themelimin e dy (2) qendrave të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi (QRBB) të cilësisë së lartë për ofrim të mundësive për rehabilitimin dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, përmes zbulimit të hershëm, rehabilitimit individual dhe udhëzimeve holistike e shërbimeve mbështetëse për anëtarët e familjes. Përfituesit kryesorë të Projektit janë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në komunën e Gjakovës dhe Ferizajit. Qendrat shërbejnë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre përmes zgjerimit të kapaciteteve të qendrave HandiKOS-it për të pasur rol shumë dimensional: ofrimin e një game të gjerë të shërbimeve direkte për fëmijët me aftësi të kufizuara, ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe mbështetjes për prindërit/kujdestarët dhe angazhimi në avokim për qasje më të madhe në mundësitë dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

## **Shërbimet e bazuara në Komunitet për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara**

Shërbimet e bazuara në Komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara ofrohen në Qendrat RBB nga një ekip multidisiplinar. Shërbimet që ofrohen në Qendrën e Handikos në Gjakovë dhe në Ferizaj, përfshijnë një larmi programesh të hartuara për të përmbytur nevojat dhe interesat e përfituesve të shërbimit si edhe referime apo mbështetje për të përdorur shërbime të ofruara nga struktura të tjera të specializuara, me synimin përfundimtarë: ofrimin në vazhdimësi të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe rehabilitimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara brenda komunitetit.



Shërbimet që janë përkrahur përmes projektit të MACP-së kanë filluar në fillim të vitit 2016 dhe pritet të zgjasin deri në fund të vitit 2018. Komponentët kryesorë të këtij modeli të krijuar kanë përfshirë:

1. Mbështetje në ofrim të shërbimeve direkte për fëmijët me aftësi të kufizuara
2. Mbështetje të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fuqizim të tyre për të ofruar mbështetje më të mirë për zhvillimin e fëmijëve të tyre dhe për të avokuar për të drejtat e tyre, dhe
3. Rritje të kapaciteteve të akterëve relevantë lokalë, siç janë OJQ-të dhe autoritetet e qeverisjes lokale për të ofruar, mbështetur dhe ndoshta vazhduar këto shërbime edhe pas kohëzgjatjes së projektit.

Shërbimet kanë të bëjnë me përfshirjen, mbështetjen dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara fizike dhe intelektuale, prindërve dhe familjarëve të tyre për mes aktiviteteve që ofrohen në qendrat e HandiKOS. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në aktivitetet që ofrohen në Qendra mundësojnë fuqizimin e zërit të tyre, parandalimin dhe avancimin e gjendjes shëndetësore, zhvillimin e aftësive fizike dhe intelektuale, motivimin, ngritjen e njohurive të familjarëve mbi mundësitë dhe aftësitë e fëmijëve të tyre, socializmin, ambientimin me rrethin shoqëror dhe para përgatitjen e fëmijëve për kyçjen në proceset arsimore në shkolla të rregullta dhe integrimin e përgjithshëm të tyre në shoqëri. Ofrimin e shërbimeve rehabilituese, njohje dhe pjesëmarrje të plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shoqëri, mbulimin me pajisje ndihmëse (karroca, kukëza, shëtitore etj), të cilat janë më se të domosdoshme për ta, dhe organizimin e aktiviteteve tjera rehabilituese me qëllim të pavarësisë së tyre për aktivitetet ditore. E gjithë kjo është në funksion të realizimit të vizionit për një shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje të plotë të drejtave të barabarta për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Shërbimet ofrohen në kuadër të Strategjisë së Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi (RBB) që orientohet nga parimi i respektimit të të drejtave, i të qenurit një ambient i hapur, i respektueshëm dhe me një sjellje të natyrës pjesëmarrëse ku mendimi i përfituesve të shërbimit kërkohet dhe merret në konsideratë. Ofrimi i shërbimeve mbështetet në parimin për të kontribuar në ngritjen e një modeli të qëndrueshëm integrimi e zhvillimi, i cili synon të garantoj për të gjithë mundësinë e përmbushjes së nevojave bazike, si edhe një perspektivë zhvillimi të qëndrueshëm për të ardhmen.

Shërbimet me bazë në komunitet ofrohen me cilësi të lartë, janë shërbime profesionale, efikase dhe relevante për përfituesit e tyre. Shërbimet multidisiplinare për fëmijët me aftësi të kufizuara ofrohen në përputhje me nevojat e vlerësuara, terapi individuale, në shkollë, terapi në shtëpinë ku jeton përfituesi, vlerësim nevojash, informim, këshillim për prindërit, ndihmë ligjore, orientim drejt shërbimeve publike e jopublike, fuqizim kapacitetesh të prindërve dhe punonjësve të shkollave, shërbime psiko-sociale, ndërgjegjësim të komunitetit, etj.

Shërbimet ndahen në:

1. Shërbime të drejtpërdrejta për fëmijët/ të rriturit me aftësi të kufizuara si:
  - a. Vlerësime profesionale të nevojave, aftësive dhe shkathtësive (përmes vizitave familjare dhe punës në qendër)
  - b. Terapi individuale, familjare dhe grupore, terapi të artit dhe lojës
  - c. Programe të specializuara (si Portage, Heart, programe edukative, programe për fuqizimin e komunikimit, programe të motorikës fine dhe grose, programe të modifikimit të sjelljes, programe të autonomisë personale, për jetesë të pavarur, etj)
  - d. Këshillim mjekësor, psikosocial, edukativ dhe ligjor

- e. Rehabilitim primar fizik, psikosocial dhe mendor
  - f. Parandalimi i pasojave si rezultat i aftësisë së kufizuar
  - g. Pajisje ndihmëse
  - h. Shërbime për jetesë të pavarur
  - i. Shërbime individuale terapeutike, mbështetëse, edukative dhe informuese në shtëpinë ku jeton përfituesi
2. Mbështetje dhe ngritje të kapaciteteve të familjarëve të përfituesve
- a. Informim dhe këshillim
  - b. Këshillim familjarë
  - c. Mbështetje në avokim
  - d. Motivim dhe inkurajim të prindërve përmes takimeve konsultative individuale dhe grupe
  - e. Orgazimim të takimeve të rregullta grupe me qëllim të shkëmbimit të përvojave
  - f. Përkrahje dhe monitorim të aktiviteteve të cilat prindërit duhet ti kryejnë në shtëpitë e tyre, ndërtimi i ulëseve speciale për fëmijë, referencat ortopedike, etj.
3. Ndërgjegjësimi i komunitetit për të mbështetur gjithëpërfshirjen
- a. Bashkëpunim me shkollat dhe kopshte; Bashkëpunimi me ofrues tjerë të shërbimeve; Aktivitetet ndërgjegjësuëse
  - b. Organizim të punëtorive, seminareve dhe tryezave të rrumbullakëta lidhur me të drejtat e njeriut/fëmijëve me aftësi të kufizuara

- c. Organizim të fushatave/ kampanjave lidhur me avancimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- d. Organizim të shënimeve të datave me rëndësi për personat me aftësi të kufizuara.
- e. Pjesëmarrje në krijimin e politikave dhe strategjive lokale me qëllim të përfshirjes së interesave të personave me aftësi të kufizuara.
- f. Bashkëpunim me strukturat relevante lidhur me përmirësimin e qasjes dhe lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara.

Shërbimet e mësipërme ofrohen nga Qendrat që kanë personel të trajnuar në fushat relevante që ofrojnë shërbimet me respekt, besueshmëri dhe qasje njerëzore. Qendrat poashtu ofrojnë shërbimet nëpërmjet bashkëpunimeve me struktura tjera të specializuara publike dhe jopublike.

Qendra RBB ofron shërbime për përfituesit, përgjatë orarit 08:00 deri 16:00. Qendra ju ofron përfituesve të shërbimeve mbështetje 5 ditë në javë nga e Hëna deri të Premten. Qendra qëndron e mbyllur në fundjavë dhe gjatë festave zyrtare.

## **Përfituesit e Shërbimeve të bazuara në Komunitet**

Përfituesit primar të shërbimeve të bazuara në komunitet janë fëmijët me aftësi të kufizuara të grup-moshës 0- 18 vjeç dhe familjet e tyre.

Përfituesit në Qendrën e Kujdesit Ditor planifikojnë, zgjedhin dhe kryejnë një sërë aktiviteteve dhe marrin pjesë në përvojën e komunitetit në mënyrë që të arrijnë mënyra të ndihmës së vetvetes,

autonomi, bashkë-ekzistencë sociale dhe pjesëmarrje. Pjesëmarrja në qendër është me baza vullnetare. Prindërit të cilët mund të jenë të interesuar për të sjellur fëmijët e tyre dhe për t'iu bashkuar qendrës, mund të vetëreferohen, të referohen nga dikush tjetër, zakonisht nga një punëtor mjekësor, punëtor social apo anëtar i familjes, apo të identifikohen nga punonjësit e Qendrës HandiKOS përgjatë aktiviteteve të rregullta në terren. Pasi që Qendra e ka mundësinë të iu shërbejë një numri të kufizuar të personave, prioritet kanë nën-grupet më të ndjeshme të popullsisë së fëmijëve me aftësi të kufizuar duke u bazuar në kritere si vijon:

- Gjendja e rëndë socio-ekonomike
- Pamundësia e pjesëmarrjes në jetën sociale (për shkak të qasjes së vështirë në shërbime, ose mungesës së përkrahjes familjare)
- Mungesa e përfshirjes në aktivitete edukative- rekreative, mosmundësia e vijimit të shkollës
- Mungesa e mbështetjes nga Shteti

Kriteret tjera të përparësisë përfshijnë fëmijët që:

- Kanë nevojë për shërbime holistike
- Janë të aftë të lëvizin të pavarur përfshirë këtu edhe me karrocë me rrota
- Nuk paraqesin probleme të rënda të sjelljes dhe të shëndetit mendor
- Vendosin me dëshirë të plotë të frekuentojnë dhe të ndjekin programin e Qendrës RBB

Pjesëmarrja në QRBB percaktohet nga pikët totale nga kriteri që përmbushet në forma të regjistrimit. Nëse më shumë fëmijë janë

në nevojë të marrin shërbime nga qendra, asistenti/ja administrative mban kontakt me ta, që t'i informojë për ndonjë aktivitet social ose/dhe shëtitje që organizohet, në mënyrë që ata të bashkëngjiten nëse janë të interesuar.

Pos kësaj, sistemi referues është në proces të themelimit në mënyrë që përfituesit të kenë qasje në shërbime tjera publike ose/dhe shërbime mjekësore. Procesi do të inicohet nga psikologu duke e mbushur formularin referues. Formulari referues i përcillet asistentit administrativ në mënyrë që të caktojë takimin dhe ti marrë gjithë masat e nevojshme (p.sh. transportin, shoqërimin etj.)

Momentalisht në Qendër në Handikos në Ferizaj përfitues të rregullt të shërbimeve janë rreth 60 fëmijë dhe familjet e tyre, përderisa në Gjakovë përfitues të rregullt të shërbimeve janë afro 75 fëmijë dhe familjet e tyre.

## **Punonjësit e Shërbimeve të bazuara në Komunitet**

Për të përmbushur nevojat dhe shërbimet cilësore të qendrës RBB për fëmijët me aftësi të kufizuara, qenësor është ekipi profesional. Profesionistët e përfshirë në menaxhimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore kanë kualifikime dhe eksperiencë të ndryshme të punës dhe arsimit sikur në fushën e sociologjisë/punës sociale, psikologjisë, administratës dhe menaxhmentit. Krahas kësaj, i gjithë ekipi ndihmon në implementimin e çdo aktiviteti në program si dhe në dhënien e shërbimeve. I gjithë ekipi po ashtu kanë përgjegjësi shtesë, sikur se prezenca në takime të ekipit, seanca të mbikëqyrjes (nëse përshtatet) dhe takime javore për qëllime të ndryshme (monitorimi dhe progresi i anëtarëve të grupit, dizajnimi i aktiviteteve dhe organizimi i programit, etj.)

Përveç anëtarëve të ekipit, aktualisht po punohet në formimin e një rrjeti të vullnetarëve, të cilët mund të asistojnë në dhënien e

shërbimeve të qendrës. Menaxheri i qendrës dhe asistenti administrativ kanë rol kyç në koordinimin e aktiviteteve dhe trajtimin e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm. Komunikimi i brendshëm i referohet komunikimit mes anëtarëve të ekipit, vullnetarëve (organizimin dhe informimin në mbledhje javore), anëtarët e grupit (përfituesit), familjet e tyre si dhe gjithë individët e tjerë të interesuar në aktivitetet e qendrës ditore. Ndërsa, komunikimi i jashtëm i referohet akterëve relevant dhe palëve të interesuara, sikur qeveria dhe komuniteti lokal, sektori publik, media, OJQ-të relevante, sektori privat, etj.

Personeli i Qendrës RBB për shërbimet për fëmijë me aftësi të kufizuara përbëhet nga pozitat në vijim:

- |                                      |                        |
|--------------------------------------|------------------------|
| 1. Menaxheri i Qendrës               | 4. Psikologu           |
| 2. Asistent terreni në komunitet     | 5. Fizioterapeuti      |
| 3. Asistent i bibliotekës së lodrave | 6. Edukatori jo-formal |
|                                      | 7. Vozitës             |

Çdo punonjës i QRBB përfaqëson organizatën në baza ditore. Sjellja e tyre ndikon në përshtypjen e komunitetit ndaj QRBB si dhe në zhvillimin e përgjithshëm të atyre që përfitojnë shërbime.

Punonjësve u kërkohet të njihen me parimet dhe rregulloret e vendosura nga HandiKOS, dhe të punojnë në përputhje me këto parime dhe rregullore. Kjo siguron një kuptim të qartë të përgjegjësisive individuale, të drejtave dhe detyrimeve, dhe promovon një klimë stabiliteti dhe bashkëpunimi.

Punonjësve u kërkohet të njihen me organizatën dhe të sillen në përputhje me vlerat e deklaruara. Çdo punonjës luan një rol në mbështetjen e misionit të QRBB dhe duhet të përpiqet të kryejë punën e tij me ndërgjegje dhe zell, me integritet dhe ndershmëri. Punonjësit punojnë së bashku në një frymë respekti të ndërsjellë, duke zgjidhur problemet në mënyrë të përgjegjshme dhe profesionale.

Menaxheri i Qendrës dhe punonjësit tjerë janë punonjës të kontraktuar me kohë të plotë dhe të pjesshme, në bazë të kontratave të punës të nënshkruara mes punonjësit dhe HandiKOS.

Qendra ka punonjës që ofrojnë shërbime direkte për përfituesit e qendrës në përputhje me nevojat e këtyre të fundit. Për shkak të natyrës së shërbimit për përfitues, raporti përfitues për staf ndryshon në funksion të ndërhyrjes/programit. Pavarësisht programeve, raporti përdorues për staf nuk duhet të jetë asnjëherë me i madh se 8 përfitues shërbimi për çdo punonjës.

Përgjatë aktivitetit ditor, Qendra menaxhohet nga Menaxheri i Qendrës, i cili drejton një kompleks çështjesh nëpërmjet një sistemi menaxhimi dhe procesesh të cilat mundësojnë një drejtim sa më të lehtë dhe efektiv. Menaxheri i Qendrës ka si detyrë kryesore realizimin e shërbimeve me profesionalizëm, në përputhje me standardet dhe legjislacionin në fuqi. Detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxherit janë si vijon:

*Menaxhimi i Qendrës, mbikqyrja e shërbimeve, garantimi i shërbimeve cilësore, me standarde dhe profesionale, koordinimi i stafit të Qendrës, përgatitja dhe zhvillimi i aktiviteteve të Qendrës, koordinimi dhe bashkëpunimi me partnerin e projektit, bashkëpunimi me partnerët tjerë dhe institucione me qëllim të arritjes së objektivave të projektit, orientim, këshillim, ndihmë dhe përkrahje e stafit të Qendrës, procedimi i shpenzimeve të Qendrës në kuadër të projektit. Është përgjegjës për stafin e Qendrës në kuadër të projektit, për përgatitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve. Kryen edhe shërbime administrative dhe procedurale të Qendrës që lidhen me punën në kuadër të projektit. Ndihejmon organizatën për çështje të ndryshme, hulumtim të shpalljeve për grante dhe financim të projekteve dhe hartim dhe zhvillim të propozim projekteve, si dhe çështjeve për shërbimet për personat me aftësi të kufizuara. Përfaqëson organizatën nëpër aktivitete e Qendrës në kuadër të projektit, tryeza, konferenca dhe trupa tjerë që e autorizon organizata. I punësuari kryen edhe punë dhe detyra tjerë sipas nevojave të Organizatës HandiKos.*



**Asistenti i terrenit** në komunitet është përgjegjës për vizitat në familje, institucionet arsimore, sociale dhe shëndetësore; grumbullimin e të dhënave për rastet e reja të identifikuara të familjarëve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara të pa përfshirë në sistemin arsimor dhe bën listën e institucioneve arsimore, shëndetësore dhe sociale që ofrojnë shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara; ndikon në ndryshimin e qëndrimeve publike nëpërmjet vendosjes së kontakteve më të ngushta me prindërit, fëmijët dhe Qendrën përmes realizimit të ngjarjeve dhe fushatave mediale; ofron këshillime familjare dhe shërbime psiko - arsimore për forcimin e familjes dhe mirëqenien e fëmijëve me aftësi të kufizuara; ndërgjegjësimin e komunitetit në ngritjen e aktiviteteve bazuar në rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve në edukim; seanca informuese me prindërit për shërbimet që ofrohen për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për përdorimin më të mirë të këtyre shërbimeve; angazhim dhe mobilizim të institucioneve relevante dhe komunitetit për krijimin e fondeve dhe burimeve të duhura për të adresuar nevojat e familjeve, fëmijëve dhe adoleshentëve për përfshirje sociale; avokim dhe lobim në fuqizimin e ekipeve të vlerësimit të përbërë nga ekspert të fushave (arsimore, sociale dhe shëndetësore), duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara; prodhimi dhe shpërndarja e broshurave dhe dokumenteve, duke përfshirë praninë në programet e medie të shkruara dhe atyre elektronike, përmes fushatave sensibilizuese në promovimin e të drejtave të fëmijëve në arsimin gjithëpërfshirës parafillor dhe atë fillor.

**Asistenti i bibliotekës së lodrave** ofron shërbimin e bibliotekarit të lodrave për fëmijët dhe adoleshent me aftësi të kufizuara; zhvillon aktivitetet në librarinë e lodrave për fëmijët dhe adoleshent me aftësi të kufizuara; përmes lodrave ndihmon fëmijët me aftësi të kufizuara pë të mësuar; ofron terapi të fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes lodrave; ofron terapi për nevoja jetësore dhe jetë sa më të pavuar për fëmijët dhe adoleshentët me aftësi të kufizuara përmes lodrave të improvizuara si pajisje shtëpiake; kujdeset për sigurinë e fëmijëve dhe adoleshent me aftësi të kufizuara gjatë seancave dhe aktiviteteve në bibliotekën e lodrave.

**Psikologu** ofron seanca profesionale (individuale, grupore, terapi loje, terapi arti, terapi dramë); këshillimet psikologjike dhe mbështetjet për fëmijë dhe adoleshent; këshillime psikologjike grupeve vetë-përkrahëse për fëmijët me aftësi të kufizuar; këshillime psikologjike për fuqizimin e familjes dhe mbështetjen e prindërve; këshillim familjar dhe shërbime psiko - arsimore për forcimin e familjes dhe mirëqenien; konsultimet mbështetëse; dhe terapi familjare.

**Fizioterapeuti** është përgjegjës dhe ofron shërbime të rehabilitimit primar fizikal (fizioterapisë) pesë ditë në javë, me fëmijët me aftësi të kufizuar; ofron shërbime terapi fizikale alternative të rehabilitimit për fëmijë; ergoterapi; fizioterapi grupore; këshilla për pozita dhe fizioterapi primare në familjet e fëmijëve; pozicionimi dhe ushtrimet relaksuese; mobilizimi pasiv i ekstremiteteve; stimulimet e muskujve, sidomos për qëndrimin e drejt të kokës; stimulimi i cili aktivizon mobilizimin në pozita të ndryshme; trajnime për përmirësimin e balansit në pozita të ndryshme: ulur, ulur në gjunjë, qëndrimi i drejtë, etj., trajnime për uljen e përshtatshme e cila parandalon deformitetet; trajnimi lidhur me komunikimin, të vetë ushqyerit, etj.

**Edukatori jo-formal** ofron shërbime si lehtësimi i procesit të regjistrimit në shkollat e zakonshme të fëmijëve me aftësi të kufizuar, mbështetjen dhe monitorimin e përfshirjes së tyre dhe rezultateve të të nxëniet; zhvillimi i edukimit joformal për përgatitje për regjistrim në shkollë; zhvillimi i edukimit joformal pas orëve të mësimi për arsimim mbështetës; shërbimin e kujdesit dhe mbështetjes me bazë në shtëpi për fëmijët që nuk janë fizikisht në gjendje të vijnë në qendrën apo shkollën; fuqizimin e familjes dhe mbështetjes së prindërve; forcimin e ekipeve të vlerësimit në mes të shëndetësisë, arsimit dhe shërbimeve sociale, dhe për të forcuar kapacitetin e tyre të bashkëpunimit dhe mbështetjes së fëmijëve dhe familjeve në nevojë; aktivitetet argëtuese që promovojnë përfshirjen sociale dhe pavarësinë.

**Shërbimet logopedike dhe mjekësore** (si parandalimi e trajtimi i sëmundjeve sekondare, dhe këshillat për medikamentet, higjienën dhe kujdesin vetanak) ofrohen në bashkëpunim me partnerët lokal.

I gjithë stafi angazhohet në organizimin e aktiviteteve si: organizimin e takimeve të rregullta; organizimin e seminareve mbi të drejtat e njeriut; organizimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe rekreative, krijimin e fokus grupeve; organizimin e ditëve të rëndësishme, etj.

**Vozitësi** ofron shërbimet për nevojat e Qendrës gjatë zhvillimit të aktiviteteve të projektit dhe nevojave tjera të Qendrës dhe stafit. Bën transportimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në mënyrë profesionale sipas nevojave dhe specifikave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, kujdeset për sigurinë e tyre gjatë transportit, kujdeset për akomodim të përshtatshëm dhe të sigurtë në automjet, bënë vendosjen dhe zhvendosjen në automjet, mirëmban automjetin dhe përcjellë gjendjen teknike të automjetit.

Shërbimet e ofruara deri më tani kanë nxjerr në pah edhe nevojën për një profesionist nga fusha e Logopedisë dhe Pedagogjisë Speciale, si dhe nevojën për një Edukator Jo-formal shtesë, që do të ofronte shërbime në terren, në shtëpitë e fëmijëve.

Qendra mban të dokumentuar për të gjithë punonjësit e saj, si edhe vullnetarët dhe studentët që bëjnë praktikën, të dhëna që përfshijnë:

- emrat e personave që kanë kryer shërbimin,
- datën e lindjes,
- përvojat e mëparshme,
- kualifikimet/arsimimin, trainimet
- ditën e fillimit të shërbimit (dhe ditën e largimit)
- postin e mbajtur dhe orët e punës në një muaj

Menaxheri i Qendrës regjistron çdo ditë numrin e stafit të paraqitur në detyrë, ndërsa çdo muaj regjistron numrin e klientëve të shërbyer prej stafit të qendrës. Në rast se një përfitues shërbimi trajtohet nga më shumë se një punonjës i qendrës, atëherë shënohet edhe numri i orëve të angazhuar me të.

Takimet e stafit kryen çdo ditë dhe sa herë që është e nevojshme. Takimet e stafit dokumentohen dhe në dokumentin e takimit shënohet:

- Data e takimit
- Qëllimi i takimit
- Emrat e pjesëmarrësve në takim
- Përmbajtja e diskutimeve
- Veprimet e konkluduara, përgjegjësit dhe koha e kryesjes së veprimeve/ndërhyrjeve të veçanta.

### *Vullnetarët dhe studentët praktikantë*

Në Qendër mirëprehen vullnetarë dhe studentë praktikantë të kontibudojnë me punën e tyre, duke respektuar parimin e interesit më të mirë të përdoruesve të shërbimit. Për këtë, Qendra ka një procedurë për rekrutimin e vullnetarëve dhe studentëve praktikantë që përfshin verifikimin, trajnimin afatshkurtër dhe menaxhimin e tyre.

Secili vullnetar apo student praktikant para se të fillojë punën, në Qender merr me shkrim qëllimin e aktivitetit të qendrës, politikën e mbrojtjes së fëmijëve dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Ashtu si edhe për stafin edhe për vullnetarët apo studentët praktikantë, dokumentohet aktiviteti në qendër lidhur me orët e punuara dhe punët/detyrat e kryera. Për të qënë vullnetar i Qendrës, personi i interesuar plotëson një formular, që shërben si pikënisje për pranimin apo refuzimin. Në përfundim të shërbimit, qendra lëshon dëshmi të praktikës për vullnetarët dhe studentët.

## Organi Drejtues

Qendra është në proces të themelimit të organit jo formal drejtues i cili do të jetë përgjegjës për të gjitha çështjet thelbësore për realizimin e qëllimeve të Qendrës, përfshirë sigurimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, rrjetëzimin e Qendrës në komunitet, avokimin për nevojat e përfituesve dhe familjarëve të tyre, si dhe bashkëkoordinimin e aktiviteve me Qendrën.

Organi jo formal drejtues planifikohet të takohet çdo tre muaj dhe të përbëhet nga ekipi i projektit dhe partnerët implementues, për qëllime të monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve. Gjatë këtyre takimeve, Menaxheri i Qendrës do të prezantojë progresin në Planin e Zbatimit të Projektit, sukseset dhe sfidat. Anëtarët e organit drejtues do të njoftohen me shkrim, në datën dhe vendin e takimit, të paktën dy javë përpara (kjo periudhë mund të përjashtohet në rastin e takimeve të jashtëzakonshme). Njoftimi për takimin e Organit Drejtues do të mbështetet me dokumentet përkatëse për takim, siç janë rendi i ditës, raportet etj;

## Punësimi i punonjësve

Procesi i rekrutimit përbëhet nga një numër fazash të cilat duhet të menaxhohen në mënyrë profesionale. Më poshtë shpjegohen hapat më kritik të këtij procesi.

Analiza e nevojës për pozitën e re të punës

Përcaktimi i profilit dhe përshkrimit të punës

Përgatitja e një njoftimi për pozicionin e lirë të punës

Pranimi dhe egzaminimi i aplikimeve

Përcaktimi i metodë së përzgjedhjes

*Testimet*

*Intervista*

Kontrolli i referencave

Nënshkrimi i kontratës, krijimi i dosjes personale me dokumentacionin e nevojshëm

Programi i orientimit

Vlerësimi i periudhës provuese

## Zhvillimi i punonjësve

Punonjësit në qendër trajnohen në mënyrë të vazhdueshme mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre si dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit nga, si dhe mbikqyren në vazhdimësi. Përpos programit të përgjithshëm të orientimit që siguron se punonjësi i ri e ka kuptuar organizatën, përfshirë vizionin, misionin, vlerat, të kaluarën, strukturën, politikat dhe praktikën e punës, punonjësit i nënshtrohen edhe trajnimeve periodike dhe vjetore të shkathtësive, bazuar në nevojat e përfituesve të shërbimeve si dhe nevojave që dalin nga vlerësimi i performancës së punonjësve.

Duhet cekur se projekti i realizuar ka ofruar ngritje dhe avancim profesional të stafit të të dy qendrave, duke rritur kualitetin e shërbimeve, e që kërkohet të sigurohet në vazhdimësi, jo vetëm për punonjësit e këtyre dy qendrave, por për të gjithë profesionistët që janë në kontakt dhe ofrojnë shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

Përgjatë projektit të financuar dhe implementuar në partneritet nga Save the Children janë ofruar trajnimet në vijim:

- Trajnimi për Fizioterapi
- Trajnimi për shkathtësi jetësore dhe aktivitete për gjenerim të të ardhurave
- Trajnimi për terapi të punës
- Metodologjia me fëmijën në qendër për këshillim psikologjik
- Këshillimi dhe Menaxhimi i Rastit
- Metodologjia Portage

- Këshillimi i Prindërve për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sëmundje kronike
- Si të themelohet dhe udhëhiqet biblioteka e lodrave
- Trajnimi Heart
- Qendra i dokumenton të gjitha trajnimet e kryera prej saj dhe nga tjerët të kontraktuar nga Qendra.
- Qendra RBB përgatit një plan vjetor trajnimi dhe zhvillimi, të cilën e rishikon çdo vit në përputhje me nevojat individuale të punonjësve, si edhe realizon vlerësime të njohurive dhe performancës së stafit pas trajnimit.

## Puna me përfituesit

Puna me secilin fëmijë në qendër të RBB bazohet në qasje individuale dhe në procesin e menaxhimit të rastit. Menaxhimi i rastit është një komponent i rëndësishëm i praktikës në qendra dhe përdoren sidomos në ofrimin e shërbimeve për fëmijët të cilët kërkojnë përgjigje profesionale shumëdisiplinore. Si e tillë, besohet të jetë një metodë efikase dhe me kosto efektive për ofrimin e shërbimeve të shumëfishta, gjithëpërfshirëse dhe intensive. Menaxhimi i rastit është një mënyrë për të rritur fleksibilitetin, vazhdimësinë dhe reagimin e ofrimit të shërbimeve; për të siguruar një qasje të gjithëmbarshme gjatë planifikimit dhe vlerësimit të rasteve bazuar në nevojat individuale dhe pikat e forta të fëmijës dhe familjes së tij / saj.

Menaxhimi i rastit është një mënyrë e organizimit dhe kryerjes së punës me përfituesin për të adresuar nevojat individuale të fëmijës (dhe familjes së tij/saj) në mënyrë të përshtatshme, sistematike dhe me kohë, nëpërmjet mbështetjes dhe/ose referimeve të drejt-përdrejta dhe në përputhje me objektivat e organizatës.

Duke qenë një qasje e ofrimit të shërbimeve, menaxhimi i rastit synon të përmbushë qëllimet e mëposhtme në punën me fëmijët me aftësi të kufizuara:


- Të plotësojë nevojat e kujdesit, edukimit, mbrojtjes dhe mbështetjes individuale të fëmijës;
- Të rrisë pikat e forta të fëmijës / familjes dhe të mobilizojë burimet ekzistuese të tyre;
- Të mbajë dhe inkurajojë funksionimin e pavarur të fëmijës/familjes në masën më të plotë të mundshme;
- Të parandalojë dhe zvogëlojë efektet negative të situatës së jetës;
- Të krijojë një rrjet të mbështetjes sociale dhe edukative në komunitet në mënyrë që të zvogëlohet marginalizimi dhe të mbështesë integrimin e fëmijëve dhe të familjeve;
- Të avokojë në emër të fëmijës / familjes për marrjen e shërbimeve dhe burimeve të nevojshme;
- Të mobilizojë shërbimet ekzistuese sociale në komunitet për të mbështetur më mirë fëmijën / familjen;

Në qendrat RBB në Ferizaj dhe Gjakovë, procesi i Menaxhimit të Rastit aplikohet me rregull dhe vijon këto hapa:

- Identifikimi / Regjistrimi
- Vlerësimi (nivelet fillestare dhe gjithëpërfshirëse të vlerësimit)
- Planifikimi individual i rasteve
- Zbatimi i planit
- Përcjellja dhe rishikimi
- Mbyllja e rastit



Diagrami më poshtë sqaron më në hollësi rrjedhën e këtyre hapave



Jo të gjitha rastet i nënshtrohen këtij procesi të menaxhimit të rastit. Vetëm rastet të cilat do të marrin shërbime për periudhë më të gjatë se 3 muaj.

Qendra RBB posedon udhëzuesin e plotë të punës për Këshillim dhe Menaxhim të Rastit, mbi parimet e të cilit edhe organizohet puna individuale me secilin përfitues dhe secilën familje.

## Dokumentimi i procesit të menaxhimit të rastit

Puna me dokumentacionin është një pjesë thelbësore e detyrave të punonjësit të rastit dhe ngarkesës së punës. Kjo është për shkak të faktit se shërbimet sociale të ofruara nga punonjësi/organizata janë të mbikqyrura nga autoritetet vendore, organet e financimit,

si dhe organet gjyqësore. Menaxhimi i rastit përfshin edhe ndërveprimin profesional dhe personal ndërmjet punonjësit të rastit dhe fëmijës / familjes që ka një efekt të rëndësishëm në jetën e tyre.

Mbështetja e një fëmije/familjeje individuale përfshin një numër institucionesh që punojnë në bashkëpunim të ngushtë dhe kërkojnë shkëmbim të vazhdueshëm të informacionit. Prandaj, standardet e cilësisë në punë edukative dhe sociale kërkojnë që të gjitha aktivitetet e kryera nga punonjësi i rastit gjatë fazave përkatëse të menaxhimit të rasteve të dokumentohen në mënyrë të përshtatshme në dosjen e fëmijës / familjes.

Format kryesore të mëposhtme përdoren për dokumentimin e procesit të menaxhimit të rasteve në secilën nga fazat dhe renditen në dosje si vijon:

### **Faza 1: Regjistrimi**

- Forma e referimit
- Forma e vlerësimit fillestar
- Dokumentet e mbledhura nga institucionet tjera
- Kontrata me familjen
- Referimi në institucionet/shërbimet tjera

### **Faza 2: Vlerësimi:**

- Forma e vlerësimit gjithëpërfshirës
- Vlerësimet nga specialistët në vazhdimësi (brenda dhe jashtë organizatës)

### **Faza 3: Plani i Zhvillimit**

- Forma e planit të zhvillimit

#### **Faza 4: Zbatimi**

- Forma e kontaktit me familjen
- Rregjistrat e sesioneve individuale
- Përmbledhja nga diskutimi me ekipin multidisciplinary
- Forma e vizitës familjare

#### **Faza 5: Përcjellja dhe rishikimi**

- Forma e rishikimit të rastit

#### **Faza 6: Mbyllja e rastit**

- Deklarata e mbylljes së rastit
- Raporti përfundimtar për fëmijën
- Forma e monitorimit pas mbylljes

## **Indikatorët e suksesit**

Indikatorët në vijim praktikohen gjatë procesit të menaxhimit të rastit:

- Numri i fëmijëve dhe familjeve të cilët trajtohen në shërbimet e rregullta (fizioterapi, edukim joformal, terapi, seanca psikologjike, programin e bibliotekistes së lodrave)
- Numri i tretmanëve të fëmijëve në të gjitha shërbimet.
- Numri i prindërve dhe familjarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, cilët asistojnë gjatë tretmanëve të fëmijëve me AK

- Numri personave qe kanë marre pajisje ndihmese te nevojshme si janë (karroca te llojeve te ndryshme, kukëza të llojeve të ndryshme, mjete për menaxhimin e inkontinences, material higjenik sanitar, mjete ne shtroje dhe mbuloje etj.
- Masa dhe sasia e materialit ortopedik të shpërndarë për fëmijët, si janë mjetet ortopedike, sanitare, higjienike, mbulojë dhe shtrojë
- Niveli i parandalimit dhe avancimit të gjendjes shëndetësore të fëmijëve
- Numri i iniciativave të marruara nga prindërit dhe familjarët, me qëllim të avancimit të pozitës së fëmijëve me aftësi të kufizuara,
- Numri i aktiviteteve kreativo-rekreative dhe numri i fëmijëve që participojnë në to,
- Numri i trajnimeve, këshillimeve dhe udhëzimeve të PAK-ve familjareve dhe prindërve mbi të drejtat e tyre,
- Numri i takimeve me institucionet lokale (qeveritare dhe atyre që ofrojnë shërbime për fëmijët)

Burimet e verifikimit për këta indikatorë janë:

- Dokumentimi i Procesit të Menaxhimit të Rastit për secilin fëmijë
- Raportet mujore dhe vjetore të Qendrës
- Raportet mbi aktivitetet specifike të cilat zhvillohen gjatë kësaj periudhe,
- Dëshmitë për numrin e fëmijëve dhe tretmanëve për secilin fëmijë veç e veç, bazuar në kartelat vlerësuese,
- Raportimet nga takimet me prindër, ku ata paraqesin vlerësimet e tyre,

- Dëshmitë bazuar në broshurat, fotot, shkrimet nga shtypi ditor i shkruar dhe ai elektronik mbi aktivitetet e Qendrës etj.

## Mbrojtja e Fëmijëve

Parimet e punës në qendër garantojnë mbështetje të specializuar nga personeli në një mjedis të sigurt, dashamirës dhe të ngritur në standarde bashkëkohor. qendra mbanë përgjegjësi që përfituesit, posaqërisht fëmijët do të jenë të mbrojtur nga keqtrajtimi, diskriminimi, lënia pas dore etj. qendra përzgjedhë personel të kualifikuar dhe zhvillon shprehitë dhe praktikën profesionale të stafit, nëpërmjet trainimit të vazhdueshëm të tyre dhe nëpërmjet politikave dhe udhëzuesve që ka vënë në funksion.

Punonjësit duhet të respektojnë të drejtën e të gjithë përfituesve për të jetuar pa frikën e keqtrajtimit. Të gjithë të punësuarit kuptojnë dhe ndjekin politikën e organizatës për mbrojtjen e fëmijëve dhe punojnë për të siguruar respektimin e të drejtave të të gjithë fëmijëve dhe përfituesve tjerë.

Punonjësit poashtu duhet të respektojnë natyrën konfidenciale të informacionit brenda QRBB, në veçanti të dhënat personale të përfituesve, dhe nuk mund të lëshojnë informacione të cilat mund të ndikojnë negativisht tek përfituesit, familjet ose reputacioni i QRBB në komunitet.

Në kuadër të këtij projekti, qendrat janë pajisur edhe me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve, një dokument kyç që qeveris organizimin e punës ditore në qendra si në raport me punën që punonjësit e bëjnë me përfituesit, ashtu edhe në raport me bashkëpunëtorët e jashtëm.

## Parimet dhe politikat e Qendrës RBB

Qendra ka një numër vlerash që janë të rëndësishme për te dhe për të cilat ofrohet kujdes si:

*Dinjiteti dhe respekti.* Duke njohur vlerat e personave me aftësi të kufizuara, veçantitë dhe të drejtën e tyre që rrjedhë nga Konventa e të Drejtave të Fëmijëve me aftësi të kufizuara, personeli i qendrës angazhohet që përfituesit të trajtohen me dinjitet dhe respekt.

*Barazia.* Është një tjetër e drejtë e patjetërsueshme e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kjo sigurohet duke bërë kujdes që shërbimet në qendër të jenë të arritshme dhe të disponueshme për të gjithë njësoj. Shërbimi i ofruar nga personeli do të mbështetet në kërkesat e standardeve dhe jo në rrethanat, të kaluarën dhe mënyrën e jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Shërbimet garantojnë mosdiskriminim për shkak të racës, kulturës, gjuhës, besimeve fetare, gjinisë, seksit ose aftësisë së kufizuar. Shërbimet mbështeten në individualitetin e klientëve, në përkushtimin, ndershmërinë dhe profesionalizmin e personelit.

*Cilësia.* Personeli drejtues nxit shërbime cilësore që mbështeten në standardet e miratuara dhe përmbushin kërkesat ligjore dhe të praktikës më të mirë të aritur. Angazhimi i tij është për të siguruar që personeli që punon do të realizojë objektivat e përcaktuara të qendrës në bazë të standardeve të miratuara.

*Pavarësia.* Duke ju ofruar mundësi përfituesve që të mendojnë / veprojnë në mënyrë të pavarur, duke siguruar sigurinë dhe pavarësinë e tyre gjatë gjithë kohës.

*Të drejtat.* Qendra angazhohet ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara për të garantuar të drejtat dhe detyrimet e ligjshme, që parashtrohen në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

*Dëgjimi dhe pjesëmarrja.* Angazhimi për të dëgjuar/ ndihmuar përfituesit e qendrës që të shprehin dëshirat dhe nevojat e tyre, në çfarëdolloj mënyre, që i përshtatet më mirë dhe të marrin pjesë

në vendimet për jetën dhe mirëqenien e tyre.

Zhvillimi dhe realizimi. Përfituesit e qendrës do të inkurajohen për të realizuar potencialin e tyre të plotë dhe do të ndihmohen të realizojnë shpresat dhe ambiciet e tyre, për të zhvilluar aftësitë e tyre në jetën e përditshme.

Çasje të lehtësuar në shërbimet. Staf i qendrës kujdeset që në çdo rast të merren në konsideratë interesat e përfituesit/es dhe të lehtësohet procesi i dhënies së mbështetjes dhe shërbimit.

*Konfidencialiteti.* Gjithë informacioni i dhënë punonjësit do të përdoret për të përcaktuar nevojat për ndërhyrje. Duhet të merren te gjitha masat për të ruajtur privatësinë dhe identitetin e përfituesit/es si dhe shënimet e mbajtura për individ do të ruhen dhe nuk do të jenë të hapura për publikun ose organizatat e tjera cilat nuk janë drejtpërdrejtë të përfshira me përfituesin/en. Shpërndarja e informacionit duhet të jetë e kufizuar në drejtim të subjekteve që e kanë të nevojshme dhe të domosdoshme të kenë dijeni lidhur me të.

Qendrat posedojnë një numër doracakësh dhe udhëzuesish, që jetësojnë këto vlera dhe udhëzojnë cilësinë e shërbimeve që ofrohen për përfituesit.

## Informimi dhe promovimi i shërbimeve

Qendra RBB ofron informacion për përfituesit e saj nëpërmjet një pako informacioni të përgatitur në format dhe gjuhë të përshtatshme për përfituesit. Kjo pako përfshin informata për:

- Qendrën, qëllimin e funksionimit, filozofinë e përkujdesjes ndaj përfituesve;
- Vendodhjen, përshkrimin e shërbimeve, grupet e synuara;
- Adresën dhe një numër telefoni;

- Procedurën e pranimit dhe kushtet e përfitimit të shërbimeve të qendrës;
- Llojin e shërbimeve që do marrin; numrin e orëve që zgjat shërbimi ose shërbimet (kur marrin më shumë se një); frekuencën e shërbimit/shërbimeve (kur marrin më shumë se një);
- Të drejtat- të drejtën për të refuzuar shërbimin; të drejtën për tu ankuar.
- Detyrimet e përfituesve të shërbimeve - të sillen në mënyre korrekte/të respektueshëm me stafin; të lajmërojnë ofruesit e shërbimeve ( stafin) për ndryshime të gjendjes së tyre.

Me qëllim përmbushjen e nevojave të përfituesve potencial/të mundshëm të shërbimeve të qendrës, qendra e shpërndan informacionin, nëpërmjet fletëpalosjeve, broshurave, posterave dhe faqes së saj në internet.

## Objektet e Qendrës RBB

Ndërtesa e Qendrës dhe ambienti përreth saj duhet të plotësojnë kriteret minimale të çasjes, mirëqenies dhe sigurisë së përfituesve dhe punonjësve.

Qendrat kanë hyrje dhe dalje të çasshme për personat me aftësi të kufizuara si dhe për makinat e emergjencës (urgjenca mjekësore, zjarrëfikësit, etj) si dhe hapësira për manovrimin e këtyre makinave në kthim apo lëvizje. Të gjitha hyrjet dhe i gjithë objekti janë të përshtatura për përdorimin e karrocave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.



Ambientet e qendrës janë të ndriçuara mirë, me dritë natyrore dhe artificiale. Ndriçimi i qendrës i mundëson përfituesit e shërbimit të lëvizin sigurtë dhe të evitohen aksidentet.

Të gjitha ambientet e qendrës janë të ventiluara në mënyrë natyrore.

Qendrat kanë sistem ngrohjeje funksional, veçanërisht në ambientet që përdoren nga përfituesit e shërbimit.

Mobilimi dhe pajisjet e qendrës janë në përshtatje me aktivitetet që kryhen në qendër dhe nxisin pavarësinë dhe sigurinë e përfituesve

Qendra kanë një numër ambientesh që ndryshojnë nga përmasat, mobilimi dhe organizimi në funksion të aktiviteteve që kryhen dhe numrit të përfituesve. Qendra duhet të posedojë:

- Dhomën e pritjes dhe informimit
- Dhomën për terapi individuale
- Dhomën për terapi grupore
- Dhomën për aktivitete, ushtrime dhe lojëra
- Zyret e punës
- Një kuzhinë të vogël

Së paku dy tualete të ndara për femra dhe meshkuj, dhe të përshtatura për përdoruesit e karrocave.

Parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve

Qendra ka pajisje për pastrimin e duarve, solucione larëse për duart, letra për fshirjen e duarve dhe shporta mbeturinash, sipas llojit dhe sasisë së mbeturinave që gjenerohen.

Ruajta e materialeve me potencial helmues (solucionet e pastrimit, etj.)

Materialet me potencial helmues duhet mbajtur në një ambient të veçantë të mbyllur dhe të pa-arritshëm nga përfituesit, sidomos fëmijët. Këto materiale duhet mbajtur larg ushqimit dhe ambienteve të grënies.

## Numrat e telefonave te emergjences

Qendra duhet të ketë të vendosura dhe lehtësisht të lexueshme numrat e telefonit të urgjencës, zjarrëfikësve, policisë, spitalit, etj.

## Ndihma e parë/e shpejtë

Qendra ka një kuti të ndihmës së shpejtë, lehtësisht të çasshme nga punonjësit e qendrës. Kutia duhet të përmbajë: solucione antiseptike, lloje të ndryshme fashosh, gaza sterile, pinceta të ndryshme, adeive për përdorim në mjekësi, gërrshërë, doracak për dhënien e ndihmës së shpejtë.

## Zjarri dhe emergjenca (paisjet, trajnimet, procedurat e evakuimit)

Qendrat kanë një procedurë të shkruar në rastet e nevojës për evakuim. Kjo procedurë bëhet në bashkëpunim me Njësinë e Zjarrëfikësve. Kjo procedurë duhet të jetë e vendosur në të gjitha ambientet e qendrës dhe të jetë e shoqëruar me hartën përkatëse të evakuimit.

Qendra duhet të ketë një sistem alarmi që funksionon në të gjitha ambientet e qendrës.

Qendra duhet të ketë aparate për fikjen e zjarrit aq sa përcaktohet nga autoritetet lokale.

Qendra duhet të ketë shenjat që tregojnë daljet, me shkronja të mëdha dhe të lexueshme në hapësirat dalëse.

Qendra duhet të ketë një inspektim vjetor mbi sigurinë ndaj zjarrit. Dokumentacioni mbi inspektimin duhet të jetë pjesë e dokumentacionit të qendrës. Fikëset e zjarrit duhet të jenë lehtë të qasshme dhe të arritshme nga punonjësit dhe përfituesit.

## Hapat e inicimit të një Qendre RBB

Për hapjen e një Qendre të ngjashme RBB ndërmerren hapat në vijim:

1. Analiza e nevojave për shërbim
2. Analiza e akterëve relevant dhe themelimi i partneriteve për zbatim
3. Themelimi, furnizimi dhe mobilimi i Qendrës për fëmijët me aftësi të kufizuara;
4. Rekrutimi i stafit për ofrim të shërbimeve të Qendrës;
5. Organizimi i trajnimit të stafit për ofrimin e shërbimeve në Qendrën e Kujdesin Ditor për PAK dhe ofruesit tjerë të shërbimeve sociale dhe shëndetësore;
6. Zhvillimi i Manualit të funksionimit të Qendrës dhe politikave/procedurave për funksionim të përgjithshëm
7. Vendosja e sistemit të menaxhimit të rastit
8. Ofrimi i shërbimeve dhe aktiviteteve
9. Monitorimi dhe vlerësimi i rregulltë i shërbimeve dhe aktiviteteve

## Praktikat rajonale në ofrimin e shërbimeve të bazuara në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara

Shqyrtimi i literaturës për shërbimet e bazuara në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara nxjerr në pah dy forma të kujdesit:

- Kujdesin ditor në komunitet- kryesisht të ofruara nga OJQ-të dhe të financuara nga nivelet lokale,

përfshin edhe shërbime parandalimi edhe shërbime rehabilituese, aktivitete rekreative, socializim, integrim në komunitet, këshillim profesional, etj.

- Kujdesin në shtëpi (nga 2-6 orë)- ofruar nga shërbimet e menaxhuara nga Komuna (mjekësia familjare), si dhe nga OJQ-të e financuara nga niveli Komunal.

Shembujt e praktikave të mira nga vendet e tjera, zbatimi i gjatë i së cilës ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin e fëmijëve dhe shoqërive gjithëpërfshirëse në përgjithësi, janë kryesisht shërbime gjithëpërfshirësi që ofrohen për fëmijët, familjet dhe komunitetin. Një shembull i praktikës së mirë në vjen nga Spanja, ku organizata ONCE ofron mbështetje të gjithanshme për zhvillimin e përfshirjes, që përfshin ndërhyrjet e hershme të fëmijërisë, ndihmën gjatë kujdesit dhe edukimit të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara, përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës. Në veçanti, Reggio Emilia, Itali, njihet si një shembull i praktikës gjithëpërfshirëse, ku i kushtohet vëmendje e veçantë mbështetjes së ekipeve të ekspertëve mobil dhe përfshirjes së të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara (pavarësisht nga lloji dhe niveli i aftësisë së kufizuar) në sistemin e kujdesit dhe edukimit. Koncepti i ndërhyrjes së hershme, cilësohet si praktikë shumë e mirë që në vetvete kontribuon në zhvillimin e pavarësisë së fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara dhe do të ndihmojë në përfshirjen e tyre në komunitet. Modeli suedez, si shembull, bazohet në qendrat e habilitimit, të cilat ofrojnë mbështetje për të gjitha sistemet që kërkojnë të zhvillojnë qasje gjithëpërfshirëse për fëmijët me aftësi të kufizuara nëpër dhomat burimore; këto dhoma ofrojnë trajtim dhe ndihmojnë integrimin e fëmijëve në shoqëri. Qendrat e Habilitimit punësojnë ekspertë që ofrojnë procedura të përditshme terapeutike për fëmijët, organizojnë mbështetje të vazhdueshme për shkollat dhe janë të hapura në baza ditore për këshillimin dhe mbështetjen psiko-sociale të anëtarëve të familjes.

Për nevojat e këtij dokumentimi janë shqyrtuar praktikat nga 5 shtete të rajonit.

**Bullgaria-** Shërbimet me bazë në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara në Bullgari ofrohen nga OJQ-të me financim të nivelit komunal. Qendrat për Kujdesin Ditor (QKD) për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara ofrojnë një sërë shërbimesh për të promovuar zhvillimin e fëmijëve, për të siguruar kujdes të plotë për ta gjatë ditës, për të përmbushur nevojat e tyre të të mësuarit, për të siguruar terapi motorike dhe të folurit, për të organizuar kohën e lirë, etj.

Puna në QKD zakonisht shënjestron:

- Fëmijët e moshës prej 3 deri në 18 vjeç të certifikuar nga një Komitet Mjekësor i Ekspertëve si: fëmijë me ëstirësi të lehta dhe të moderuara mendore, fëmijët me çrregullime ndijore ose motorike; dhe fëmijet me çrregullime të sjelljes ose çrregullime zhvillimore.
- Fëmijët e moshës nga 3 deri në 18 vjeç që kanë aftësi të kufizuara fizike të përkohshme ose të përhershme të cilët janë certifikuar nga një Komitet Mjekësor i Ekspertëve.

Shërbimet ofrohen nga një ekip multidisiplinar i përbërë nga:

- pedagogu i specializuar;
- psikologu;
- terapist rehabilitues;
- praktikues i kujdesit shëndetësor;
- Terapisti i të folurit;
- Edukatori jo-formal;

Shërbimet janë të dizajnuara për të përmbushur më së miri nevojat dhe dëshirat e fëmijëve dhe adoleshentëve për të siguruar mirëqenien e tyre. Ato përfshijnë:

1. Kujdesi i plotë ditor ose gjysmë ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara
2. Shoqërim në procesin e mëimit individual ose grupor;
3. Zhvillimi i zakoneve të ndryshme dhe aftësive jetësore, si ruajtja e higjienës personale dhe e kujdesit të fëmijëve, aftësitë e ushqimit të pavarur, higjiena e veshjeve dhe hapësira personale, aftësitë e brendshme të shtëpisë, orientimi hapësinor dhe lëvizja në rrugë, aftësitë e blerjeve;
4. Diagnostifikimi psikologjik, këshillimi dhe vlerësimi i burimeve të fëmijës dhe nevojat mbështetëse të prindërve dhe familjes;
5. Rehabilitimi
6. Terapi motorike: qëllimi është mbrojtja e sistemit motorik, zvogëlimi dhe / ose kompensimi i sëmundjes dhe funksionimi i dëmtuar i sistemit motorik, organeve të lidhura dhe sistemeve rregulluese, si dhe kufizimeve dhe / ose sfidave të mëvonshme. Përdoren metoda të ndryshme: masazh, stërvitje dhe procedura;
7. Terapia e fjalorit: përfshin diagnostikimin, parandalimin, korrigjimin, terapinë përmirësuese dhe këshillimin në fushën e çrregullimeve të gjuhës dhe të gjuhës.
8. Të mësuarit e aftësive sociale dhe aktiviteteve përfshirëse: të tilla si aftësitë e komunikimit dhe punës në grup, duke përdorur kohën e lirë, aktivitetet rekreative, zgjerimin e horizontit të tij, “zbulimin” përmes punëtorive të ndryshme grupore brenda ose jashtë Qendrës Ditore, udhëtime, vizita në institucione të ndryshme dhe hapësirat publike (me qëllim të fitimit të aftësive për t’u sjellë në publik, për të njohur traditat dhe festat) që kontribuojnë në një integrim më të mirë shoqëror;

9. Terapi e artit dhe terapi profesionale.
10. Programi i shërbimeve të orëve të specializuara: Përfshin shërbimet e ofruara nga psikologu, terapeuti i të folurit, pedagogu, terapeuti i rehabilitimit.
11. Programi për Prindërit: Ndërgjegjësimi për karakteristikat specifike të gjendjes së fëmijës së tij që vuan nga dhe për shërbimet në komunitet të dizajnuara për të mbështetur fëmijën dhe familjen, ndër të tjera;
12. Këshillimi i dizajnuar për të përmirësuar kujdesin për fëmijët dhe, nëse është e nevojshme, referimin tek specialistët jashtë Qendrës së Kujdesit Ditor, i cili mund të jetë i dobishëm për familjen dhe fëmijën;
13. Programe trajnimi për prindërit të dizajnuara për të forcuar kapacitetin e tyre prindëror, për të përmirësuar kujdesin për fëmijën me aftësi të kufizuara; të rrisin ndërgjegjësimin për karakteristikat specifike të gjendjes së të cilëve vuan fëmija, ndër të tjera;
14. Organizimi dhe kryerja e seancave të grupeve të vetë-ndihmës.

Qasja në shërbime:

Fëmijët dhe adoleshentët me aftësi të kufizuara mund të kenë qasje në shërbimet e Qendrës në bazë të kërkesës së lëshuar nga Departamenti i Mbrojtjes së Fëmijëve të Drejtorisë së Ndihmës Sociale në bashkinë lokale dhe pas nënshkrimit të një kontrate me ofruesin e shërbimit për ofrimin e shërbimit të kërkuar.

Afërsisht 60 Qendra të tilla operojnë në tërë shtetin.

**Sllovenia** - Edhe në shtetin Slloven shërbimet me bazë në komunitet ofrohen nga OJQ-të me financim të qëndrueshëm nga Komu-

nat. Një shërbim i tillë është Qendra e Këshillimit për Fëmijët, Adoleshentët dhe Prindërit në Lubjanë. Qendra e Këshillimit është një institucion profesional që sjell një sërë ekspertësh dhe herë pas here edhe bashkëpunëtorët jashtëm. Ajo punëson 28 veta, 20 prej të cilëve janë specialistë: specialistë të psikologjisë klinike, psikologë, mësues të posaçëm, dy punonjës socialë, dy psikiatër, një pedagog dhe një terapist i të folurit.

Qendra vepron si një institucion publik që integron fusha të ndryshme të kujdesit shëndetësor, arsimit dhe mirëqenies sociale. Ata ofrojmë ndihmë profesionale për fëmijët, adoleshentët dhe prindërit. Prindërit ose adoleshentët mund të marrin pjesë në konsultimin e tyre të parë me kërkesën e tyre ose nëpërmjet emërimit të bërë nga një këshillim shkollor ose një mjek i përgjithshëm.

Kurdoherë që të jetë e nevojshme dhe me miratimin e prindërve, ata gjithashtu vendosin bashkëpunim me kopshtin, shkollën fillore / të mesme, mjekun e përgjithshëm, mjekun specialist, departamentin e mirëqenies sociale dhe institucionet e tjera relevante, në mënyrë që fëmija ose adoleshenti në fjalë mund të sigurohet ndihma holistike që të jetë e mundur. Puna kombinon parandalimin, diagnostikimin, këshillimin dhe terapinë e trajtimit.

Aktivitetet përfshijnë:

- shërbime diagnostikuese, këshilluese dhe terapeutike,
- puna në grup,
- puna vullnetare,
- puna parandaluese dhe e orientuar kah komuniteti,
- arsimim jo-formal
- fizioterapi,
- punëtori artistiko-terapeutike,
- grupe prindërore



## Shërbimet diagnostike, këshilluese dhe terapeutike

Trajtimi individual bazohet në qasjen ekipore të disa specialistëve të ndryshëm që vlerësojnë problemet e fëmijës ose të adoleshentit, e mbikëqyrin atë dhe ofrojnë këshillime ose shërbime terapeutike. Me prindërit dhe mësuesit, ne, nga ana tjetër, zhvillojnë bashkëpunimin e partneritetit, duke i informuar ata për vështirësitë e fëmijës së tyre dhe për t'i inkurajuar ata që të ndihen më kompetentë në rolin e tyre.

Ndihma ofrohet për fëmijët:

- me vështirësi në mësim dhe me aftësi të kufizuara specifike të të mësuarit (sidomos në lexim, shkrim dhe aritmetikë)
- me aftësi të kufizuara fizike,
- që kanë të bëjnë me çrregullimin e deficitit të vëmendjes, deficitin afatshkurtër të kujtesës dhe probleme të tjera të kujtesës,
- probleme motorike të përgjithshme ose të veçanta, si dhe çrregullime të gjumit, ushqyerjes, urinimit dhe defekimit,
- përjetuar një traumë të rëndë, dhunë ose abuzime seksuale.
- Shërbimet poashtu ofrohen për prindërit që janë
- Të shqetësuar nëse fëmija i tyre zhvillohet siç duhet,
- Nuk e dine se si tjetër ta ndihmoj fëmijën e tyre me vështirësi në mësim,
- kërkojnë të kuptojnë natyrën e problemeve, të përjetuara nga fëmijët e tyre ose adoleshentët.

Si një shtesë e shërbimeve diagnostikuese dhe këshilluese, institucioni ofron edhe ndihmë nga vullnetarët për fëmijët që kanë nevojë për iniciativë shtesë në integrimin e tyre shoqëror. Puna vullnetare kryhet nga studentë të fakulteteve të ndryshme. Një herë në javë vizitojnë fëmijët në shtëpi ose në shkollë. Ata jo vetëm që i ndihmojnë ata të mësojnë, por edhe flasin, luajnë dhe kalojnë kohë

me këta fëmijë. Në shoqërinë e vullnetarëve, prindi mund të pushojë, të gjejë lehtësim nga presionet e ndryshme dhe të aktivizojë aftësitë e tyre. Vullnetarët janë të pajisur me programe edukimi dhe trajnimi që përmbajnë leksione dhe takime mbikëqyrëse, si dhe mundësi për t'u takuar me këshilltarët ose terapistët e tyre të mbrojtjes. Institucioni ynë gjithashtu nxit mënyra të ndryshme të bashkëpunimit në përhapjen e ideve të vullnetarëve dhe mbështet zhvillimin e projekteve të reja.

Puna parandaluese dhe orientuese me komunitete

Qendra organizon takime më të gjera ekimore në bashkëpunim me mësuesit, prindërit, mësuesit parashkollorë, shërbimet e këshillimit shkollor dhe specialistë të tjerë të përfshirë drejtpërdrejt me fëmijët, si dhe shërbimet shëndetësore dhe të kujdesit social, organizatat joqeveritare dhe të tjera që mund të kontribuojnë në çdo mënyrë për zgjidhjen e të çështjeve të kujdesit për fëmijët dhe familjen.

**Greqia-** Qendrat e Kujdesit Ditor dhe Aktiviteteve Kreative (Qendra Arsimore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara), janë themeluar që nga viti 1996 ku marrin shërbime fëmijët deri në moshën 15 vjeçare. Trajtimi gradual kujdeset për mbrojtjen sociale dhe përshtatjen ndaj shoqërisë dhe i ndihmon ata të zhvillojnë aftësi të dobishme për autonominë e tyre, vetë-shërbimin e tyre dhe jetën e tyre.

Shërbimet ofrohen për fëmijët me vonesë mendore, autizëm dhe aftësi të kufizuara.

Shërbimet dhe programe përfshijnë:

- Rehabilitim psikosocial
- Trajnimi të aftësive psikoedukative
- Aftësim për jetë të pavarur
- Këshillimi (për fëmijët dhe familjet e tyre)
- Lojë dhe rekreacion

- Aktivitete sportive dhe kulturore
- Programet e socializimit
- Seminare për aftësim për punë (me sapun, kartolina dhe qirinjë). Produktet shiten dhe gjenerohen fonde për qendrën
- Përdorim të teknologjisë informative
- Vetëdijësimi mjedisor
- Programi “Kuzhina”
- Informimi & Fushata Ndërgjegjësuese Sociale

Ekipi ndërdisiplinor përfshin:

1 Psikolog

1 Pedagog special

2 Terapistë profesionistë

1 infermiere

2 punonjës socialë

1 Shoferi + 1 dhënësi i kujdesit (përcjellja)

**Bosnja-** Modeli i Bosnjës është marrë nga modeli i financuar nga MACP, ku shërbimet e bazuara në komunitet ofrohen për fëmijët e moshës 0-18 vjeç, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, anëtarët e familjeve të tyre dhe të gjithë ata që marrin pjesë në zhvillimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.

Shërbimet ofrohen kryesisht nga dhoma e burimeve për mbështetje psiko-sociale dhe dhoma të tjera burimore sipas nevojës. Ndryshe nga shumica e institucioneve që ofrojnë vetëm mbështetje të

pjeshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, Qendrat në Bosnje (në Bihać dhe Cazin) janë të pajisura me më së shumti pajisje të sofistikuara në fushën e terapisë së të folurit, fizioterapisë, terapi profesionale dhe ndijore dhe mbështetjes psiko-sociale, e cila u mundëson atyre të ofrojnë një mbështetje gjithëpërfshirëse multidisiplinare dhe me cilësi të lartë. Shërbimet ofrojnë mbështetje për:

- fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara;
- prindërit / kujdestarët dhe anëtarët e familjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- profesionistë në fushën e kujdesit dhe edukimit, kujdesit shëndetësor dhe mirëqenies sociale;
- anëtarë të komunitetit dhe shoqërisë së përgjithshme.

Qendrat nuk ofrojnë kujdes dhe edukim gjithë-ditor ose gjysmë-ditor, por shërbime terapeutike për të cilat fëmijët kanë nevojë.

Stafi përfshinë ekipin mobil, terapistin e të folurit, fizioterapistin, terapistin e punës, terapistin e ndijimeve, këshilluesin psikosocial dhe menaxherin.

Puna bazohet në praktikat e mira që përgjigjen në nevojat e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara nga zbulimi fillestar i një aftësie të kufizuar gjatë gjithë periudhës së kujdesit dhe edukimit. Nëpërmjet punës së tyre, Qendrat inkurajojnë zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në fushat e mëposhtme: zhvillimi i gjuhës dhe të folurit, zhvillimi motorik, zhvillimi njohës, zhvillimi ndijor dhe zhvillimi socio-emocional. Një fokus i veçantë i jepet punës me familjet përmes dhomës burimore për mbështetje psiko-sociale dhe ndërveprime me komunitetin profesional dhe institucionet e tjera relevante

**Republika e Kroacisë** ka krijuar qendra burimore, roli i të cilave është të ndihmojë komunën përmes ekipeve të ekspertëve mobil dhe të ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për fëmijët me aftësi të kufizuara nëpërmjet procedurave të rehabilitimit. Këto qen-

dra kryesisht synojnë të sigurojnë zbulimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe trajtimin e hershëm për të siguruar përfshirjen më të lehtë të fëmijëve në komunitet përmes kujdesit dhe sistemit arsimor.

## **Analiza preliminare shpenzimeve për qëndrueshmëri të financimit për këto shërbime**

Nisur nga funksionimi momental i Qendrave të RBB, me stafin dhe shërbimet egzistuese, korniza buxhetore preliminare duket afërsisht si vijon:

*Shpenzimet për personelin* përfshijnë personelin në vijim:

Menaxheri i Qendrës

Edukator jo-formal

Fizioterapeuti

Psikologu

Asistenti i Bibliotekës

Asistenti i Terrenit

Vozitësi

Financieri

Mirëmbajtësi (20%)

*Buxheti preliminar: 2,361.95 Euro \* 12 muaj= 28,343.33 Euro*

*Totali për kokë të fëmijës për 1 muaj: 2,361.95 Euro / 60 fëmijë= 39.36 Euro*

**Shpenzimet operationale/programatike** përfshijnë:

Aktivitetet për fëmijët, familjet dhe komunitetin

Materialet dhe ushqimet gjatë grupeve vetndihmëse, trajnimeve me prindër, aktiviteteve rekreative

- Takimet konsultative
- Takimet informative
- Materialet ndihmëse

*Buxheti preliminar: 460.80 Euro \* 12 muaj= 5,529.50 Euro*

*Totali për kokë të fëmijës për 1 muaj: 460.80 Euro / 60 fëmijë= 7.68 Euro*

**Shpenzimet administrative** përfshijnë:

- Shpenzimet komunale (rrymë, ngrohje, ujë, komunikim)
- Mirëmbajtja e veturës
- Materialet e zyres dhe të mirëmbajtjes

*Buxheti preliminar: 322.50 Euro \* 12 muaj= 3,870.00 Euro*

*Totali për kokë të fëmijës për 1 muaj: 322.50 Euro / 60 fëmijë= 5.37 Euro*

**Totali për vit: 37,742.83 EUR**

**Totali për kokë të fëmijës për 1 muaj: 37,742.83 EUR / 12 muaj / 60 fëmijë= 52.42 Euro**

## Strategjitë e mbledhjes së fondeve

Qendrat janë në proces të hartimit të strategjive për mbledhje të fondeve të qëndrueshme për ofrimin e shërbimeve afatgjate në QRBB. Disa nga aktivitetet që janë identifikuar përfshijnë:

- I. Grantet Publike
  - a. Subvencionet nga komunat (që arrihen përmes aplikimeve në thirrjet publike)
  - b. Subvencionet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (që arrihen përmes aplikimeve në thirrjet publike)
  - c. Aplikimi për grante tek projektet vendore dhe ndërkombëtare
  - d. Granti specific për shërbimet sociale
  - e. Lirimi nga pagesat e shpenzimeve të rrymës, ujit e ngrohjes
- II. Mbledhja e fondeve (fundraising)
  - a. Mbrëmjet humanitare
  - b. Mbledhja e fondeve nga ngjarjes kulturore dhe sportive
  - c. Shitja e produkteve të punuara nga fëmijët dhe familjarët e tyre (qirinjë, kartolina, bizhuteri, etj)
- III. Donacionet nga bizneset
  - a. Stimulimi i bizneseve për donacione
  - b. Donacionet në mallëra dhe shërbime
  - c. Bashkëpunimi me biznese dhe shkolla profesionale (për serë, kuzhinë, dizajne, etj)

- IV. Sponsorizimet individuale
  - a. Stimulimi I punonjësve të organizatave, kompanive për të dhuruar shumë simbolike mujore (deri në 1 euro) për HandiKos
  - b. Sponsorizim të kurseve individuale për fëmijët
- V. Participimi i prindërve për shërbime
- VI. Ndërmarrësia sociale dhe mikro-bizneset
- VII. Përfitimi nga taksat
  - a. Marrëveshje me komunën për të marrë një përqindje nga taksat që I paguhen komunës (për mbrojtje të ambientit, regjistrim të automjeteve, etj)
- VIII. Avokimi
  - a. Për ndryshim të ligjeve dhe rregulloreve për përkrahje të shërbimeve



# **Shtojcë 1: Korniza e Shërbimeve dhe Standardet Minimale të Cilësisë së Shërbimeve Sociale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara në Qendrat e Kujdesit Ditor**

## ***Qëllimi i Shërbimeve Sociale Në Qendrat e Kujdesit Ditor për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara***

Qëllimi i qendrave të kujdesit ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara është për të promovuar integrimin e tyre në shoqërinë e përgjithshme dhe për të siguruar shërbime cilësore që kanë për qëllim plotësimin e nevojave të tyre individuale.

## ***Grupet e Prioritetit***

Grupet e prioritetit për shërbime sociale në qendrat e kujdesit ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara:

- Fëmijët me aftësi të kufizuara fizike,
- Fëmijët me aftësi të kufizuar të lehte intelektuale.

## ***Parimet Kryesore***

- Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve,
- Respektimi i fshehtësisë (konfidencialitetit) së informatave personale, pavarësisë, privatësisë, dinjitetit, mendimit dhe dëshirave të arsyeshme të fëmijëve,
- Sigurimi i qasjes individuale për të përmbushur nevojat e fëmijëve.

## **Aktivitet Kryesore të Qendrave të Kujdesit Ditor për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara**

Qendrat e kujdesit ditor organizojnë veprimet e tyre përmes aktiviteteve në vijim:

- Sigurimi i informatave – stafi, fëmijët, prindërit dhe palëve tjera të interesuara iu ofrohen informatat e duhura për qendrën dhe shërbimet e ofruara aty.
- Sigurimi i kujdesit – kujdesi ofrohet duke u bazuar në nevojat e vlerësuara të fëmijëve dhe në përputhje me planet e kujdesit individual.
- Sigurimi i kushteve të mira shëndetësore për fëmijët – ndihma e parë mjekësore është në dispozicion në qendër, nevojat e kujdesit shëndetësor janë adresuar.
- Sigurimi i ushqimit – fëmijët nuk kalojnë më tepër se tri orë pa pasur ushqim në qendër.
- Promovimi i zhvillimit të fëmijëve përmes punës individuale dhe grupore.

## Standardet minimale

Standardet Minimale Strukturale	Indikatorët e Performancës
X.1.1 Qendra do të siguroj dhe do të ripërtërijë në mënyrë të rregullt certifikatat/autorizimin nga autoritetet e zjarrfikjes dhe shëndetësisë/higjienës të Kosovës	Çertifikatat në dispozicion
X.1.2 Qendra do të siguroj që zona e hyrjes dhe ajo brenda ndërtesës janë të përshtatura që të përmbushin nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara	Objektet e adaptuara
X.1.3 Qendra do të siguroj qasje të automjeteve emergjente (auto-ambulanca, automjete për zjarrfikje, etj.)	Objektet e adaptuara
X.1.4 Qendra do të ketë një dhomë gjumi të mobiluar në mënyrë adekuate për fëmijët që kanë nevojë të shtrihen periodikisht apo nevojë për një sy gjumë.	Hapësirat adekuate në dispozicion
X.1.5 Qendra do të ketë një plan evakuimi, ndërsa stafi i qendrës do të trajnohet për të vepruar në mënyrë të përshtatshme në raste emergjente, me një theks të veçantë në evakuimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzistenca e planit të evakuimit.</li> <li>• Dëshmi të dokumentuara për njohurit e stafit.</li> </ul>
X.1.6 Qendra do të jetë e vendosur në një mjedis të sigurt për shëndetin e fëmijëve	Përputhshmëria me standardet e ndërtimit në mjedis

<p>X.1.7 Qendra do të ketë kënd të lodrave të sigurt dhe të pastër të përshtatshëm për nevojat e fëmijëve</p>	<p>Ekzistenca e një këndi të lodrave, në përputhje me standardet e këndit të lodrave të jashtëm</p>
<p>X.1.8 Qendra do të ketë një kuzhinë të pastër, të pajisur në mënyrë adekuate dhe të pajisur me një furnizim me ujë dhe mjedise të përshtatshme për të siguruar ruajtjen e sigurt të ushqimit të fëmijëve</p>	<p>Ekzistenca e kuzhinës</p>
<p>X.1.9 Qendra do të ketë tualete të veçanta për stafin dhe fëmijët. Tualetet dhe banjat për fëmijët duhet të përshtaten me nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzistenca e tualeteve të ndara</li> <li>• Objektet e adaptuara</li> </ul>
<p>X.1.10 Qendra do të siguroj që të gjitha pjesët e ndërtesës të kenë ndriçim të mjaftueshëm, ngrohje (opsione të sigurt të ngrohjes) dhe ventilim.</p>	<p>Përputhshmëria me standardet e ndërtimit që kanë të bëjnë me ndriçimin, ngrohjen dhe ventilimin</p>
<p>X.1.11 Qendra do të izolohet në mënyrë të duhur nga trafiku</p>	<p>Dëshmi të dokumentuara</p>
<p>X.1.12 Qendra do të ketë stafin menaxherial, profesional dhe mbështetës. Çdo anëtar i stafit do të ketë një përshkrim të vendit të punës të miratuar nga Menaxheri i Qendrës</p>	<p>Përshkrimet e punës të miratuara</p>

<p>X.I.13 Menaxheri i Qendrës do të sigurojë që procedurat e brendshme operacionale të shkruara janë themeluar, duke rregulluar funksionimin e përgjithshëm të Qendrës. Procedurat duhet po ashtu të specifikojnë bashkëpunimin e Qendrës me institucionet përkatëse arsimore dhe mjekësore. Orari i funksionimit do të jetë fleksibil, duke lejuar fëmijët dhe prindërit e tyre të përdorin shërbimet e qendrës në komoditetin më të mirë për ta.</p>	<p>Ekzistenca e Procedurave të Brendshme Operacionale</p>
<p>X.I.14 Menaxheri i qendrës do të formojë procedurat e brendshme të monitorimit</p>	<p>Ekzistenca e procedurave Monitoruese</p>
<p>X.I.15 Qendra do të ketë një sistem efikas të kontabilitetit.</p>	<p>Ekzistenca e sistemit të kontabilitetit</p>
<p>X.I.16 Menaxheri i qendrës do të siguroj që stafi profesional ti nënshtrohet rregullisht kontrolleve të rregullta mjekësore si dhe të regjistrohet në kurse përkatëse të trajnimit</p>	<p>Certifikatat e disponueshme mjekësore dhe raportet e trajnimit</p>

X.1.17 Qendra do të ketë një ekip të stafit shumë-disciplinarë që ofrojnë shërbime profesionale për fëmijët dhe familjet e tyre. Kërkesat minimale për stafin profesional do të jenë:

- Punëtorët e licencuar profesional (menaxherët e rastit) – çdo punëtor social (menaxher i rastit) do të menaxhoj jo më shumë se 10 raste
  - Punëtorët e licencuar profesional (edukatorët) – çdo punëtor social (edukator) do të punoj me jo më shumë se 5 fëmijë
  - Psikologu – çdo psikolog do të punoj me jo më shumë se 10 raste (fëmijë dhe familje)
  - Fizioterapeut – Qendra do të sigurojë që shërbimet profesionale të fizioterapeutit ofrohen për fëmijët sipas nevojave të tyre të vlerësuara.
  - Logopedë - Qendra do të sigurojë që shërbimet profesionale të logopedit iu janë dhënë fëmijëve sipas nevojave të tyre të vlerësuara.
- Numri i fëmijëve/ Numri i menaxherëve të rastit
  - Numri i fëmijëve /Numri i edukatorëve
  - Numri i fëmijëve/ Numri i psikologëve
  - Dëshmi të dokumentuara për shërbimet nga psikoterapeuti
  - Dëshmi të dokumentuara për shërbimet nga logopedi

X.1.18 Qendra do të punësojë kujdestarë për t'u kujdesur për fëmijët gjatë qëndrimit të tyre në Qendër	Personeli me përshkrime përkatëse të vendeve të punës
X.1.19 Qendra do të punësojë personel mbështetës, duke përfshirë edhe një kuzhinier/ndihmës kuzhine, <u>personeli pastrues etj.</u>	Personeli me përshkrime përkatëse të vendeve të punës
<b>Standardet Funktionale</b>	<b>Indikatorët e Performancës</b>
X.2.1 Qendra do të sigurojë që informata adekuate iu është dhënë fëmijëve në lidhje me shërbimet e ofruara, objektet e ndërtesës, objekteve për evakuim emergjent, informacion në lidhje me ndihmën e parë dhe të mbrojtjes në raste urgjente dhe informacione të tjera të rëndësishme për fëmijët, duke marrë parasysh moshën dhe aftësitë mendore dhe fizike të fëmijëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i fëmijëve të informuar për Qendrën/Numri i fëmijëve</li> <li>• Ekzistenca e rregulloreve të brendshme</li> </ul>
X.2.2 Qendra do të siguroj që personelit ti ofrohen informatat adekuate lidhur me objektivat statutores, funksionet e qendrës, detyrat dhe funksionet e stafit dhe rregullat e brendshme operacionale.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i personelit të informuar për Qendrën/Numrin e personelit</li> <li>• Ekzistenca e rregulloreve të brendshme</li> </ul>
X.2.3 Qendra do të siguroj informata adekuate lidhur me objektivat statutores, shërbimet në dispozicion, orarin e operimit/funksionimit dhe që stafi kyç të jetë në dispozicion për prindërit dhe vizitorët tjerë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Broshura, fletëpalosje</li> <li>• Ekzistenca e rregulloreve të brendshme</li> </ul>

<p>X.2.4 Qendra do të vendosë procedurat e pranimit dhe kriteret që duhet të miratohen nga autoritetet Komunale.</p>	<p>Ekzistenca e procedurave të pranimit</p>
<p>X.2.5 Qendra do të siguroj që fëmijët e sapo pranuar të prezantohen në mënyrën e duhur me personelin dhe fëmijët e tjerë, duke marrë parasysh moshën dhe aftësitë e tyre mendore</p>	<p>Ekzistenca e rregulloreve të brendshme</p>
<p>X.2.6 Qendra do të siguroj që fëmijët e sapo pranuar të familjarizohen në mënyrën e duhur me objektet dhe hapësirat e Qendrës, duke marrë parasysh moshën, aftësitë mendore dhe fizike të tyre.</p>	<p>Ekzistenca e rregulloreve të brendshme</p>
<p>X.2.7 Të lehtësoj procesin e adaptimit dhe integritit të fëmijëve të sapo pranuar, nëse është e domosdoshme, prindi(ërit) do të lejohet të kaloj një kohë në qendër gjatë javës së parë pas pranimit</p>	<p>Ekzistenca e rregulloreve të brendshme</p>
<p>X.2.8 Qendra do të siguroj mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas Konventës së KB për të Drejtat e Fëmijëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohuri të dëshmuara të stafit për Konventën e KB për të Drejtat e Fëmijëve</li> <li>• Ekzistenca e rregulloreve të brendshme</li> </ul>



<p>X.2.9 Qendra do të siguroj sipas rregullit të drejtat e fëmijëve në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kujdesi shëndetësor;</li> <li>• arsimimi;</li> <li>• zhvillimin dhe edukimin në familje</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunim të dëshmuar me institucionet e kujdesit shëndetësor dhe arsimor</li> </ul>
<p>X.2.10 Qendra do të siguroj sipas rregullit mbrojtjen e fëmijëve nga</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>abuzimi psikologjik dhe fizik;</u></li> <li>• <u>shfrytëzimit të punës;</u></li> <li>• <u>veprave penale;</u></li> <li>• <u>neglizhenca dhe padrejtësia;</u></li> <li>• kushtet e dëmshme për shëndetin e fëmijës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzistenca e rregulloreve të brendshme, përfshirë procedurat e ankesës (ankimimit)</li> <li>• Numri dhe natyra e ankesave</li> </ul>
<p>X.2.11 Nevojat e çdo fëmije të Qendrës do të vlerësohen. Vlerësimi do të përfshijë gjendjen sociale, arsimore, psikologjike, shëndetësore dhe nevojat e fëmijës</p>	<p>Numri i fëmijëve me nevojat të vlerësuara/Numri i fëmijëve</p>
<p>X.2.12 Kujdesi dhe mbështetja profesionale do të ofrohen për secilin fëmijë sipas një Plani të Kujdesit Individual, i shtjelluar në bazë të nevojave të vlerësuara të fëmijës. Plani i Kujdesit Individual do të shtjellohet nga ekipi multi-disciplinarë, me pjesëmarrje të prindërve dhe fëmijës, duke marrë parasysh moshën dhe aftësitë mendore të fëmijës.</p>	<p>Numri i fëmijëve me Plan të Kujdesit Individual/Numri i fëmijëve</p>

<p>X.2.13 Çdo fëmijë do të ketë një menaxher të rastit. Menaxheri i rastit do të monitoroj dhe siguroj (përcjellje të) implementimin e Planit të Kujdesit Individual dhe do të koordinoj operacionet e ekipit multi-disiplinare për çdo fëmijë.</p>	<p>Numri i fëmijëve që kanë menaxher të rastit/Numri i fëmijëve</p>
<p>X.2.14 Çdo fëmijë do të ketë një dosje personale që do të përfshij:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një kopje të certifikatës së tij/saj</li> <li>• Kopjet e dokumenteve mjekësore</li> <li>• Formulari i vlerësimit të nevojave me nevojat e vlerësuar</li> <li>• Plani i Kujdesit Individual (korrigjuar dhe azhurnuar çdo tre muaj)</li> </ul>	<p>Numri i fëmijëve që kanë dosje personale/Numri i fëmijëve</p>
<p>X.2.15 Qendra do të promovojë zhvillimin intelektual, fizik, emocional dhe kulturor të fëmijëve, sipas moshës së tyre dhe kapaciteteve personale. Aktivitetet dhe ngjarjet relevante do të planifikohen dhe organizohen brenda dhe jashtë Qendrës.</p>	<p>Vlerësimi i progresit sipas Planit të Kujdesit Individual</p>
<p>X.2.16 Qendra do të promovojë zhvillimin e shkathtësive sociale dhe vetëbesimin e fëmijëve.</p>	<p>Vlerësimi i progresit sipas Planit të Kujdesit Individual</p>

X.2.17 Asistenca dhe shërbimet do t'ju ofrohen fëmijëve përmes punës individuale si dhe asaj grupore.	Ekzistenca e Rregulloreve të Brendshme
X.2.18 Fëmijët në Qendër duhet të jenë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të anëtarëve të stafit.	Ekzistenca e Rregulloreve të Brendshme
X.2.19 Planet individuale dhe të gjitha aktivitetet e organizuara brenda dhe jashtë Qendrës duhet të marrin parasysh gjendjen shëndetësore të fëmijës.	Ekzistenca e Rregulloreve të Brendshme
X.2.20 Pajisjet e ndihmës së parë dhe materialet duhet të jenë gjithmonë në dispozicion në Qendër. Të gjithë anëtarët e stafit që punojnë me fëmijët duhet të kenë njohuri të përgjithshme të procedurave të ndihmës së parë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzistenca e pajisjeve të ndihmës së parë</li> <li>• Dëshmi e dokumentuar e njohurive të stafit</li> </ul>
X.2.21 Çdo fëmijë me dëshmi të një sëmundjeje ngjitëse (ftohje, grip, etj.) do të izolohet nga fëmijët e tjerë në Qendër. Prindërit e fëmijës me dëshminë e një sëmundjeje të tillë do të informohen menjëherë nga stafi i Qendrës.	Ekzistenca e Rregulloreve të Brendshme
X.2.22 Fëmijëve do t'iu ofrohet një drekë të balancuar ushqyese në Qendër. Diçka për të ngrënë apo darkë e lehtë do ti ofrohet fëmijëve të cilët qëndrojnë në Qendër më shumë se tre orë pas drekës, ose arrijnë në Qendër pas drekës dhe qëndrojnë për më shumë se tre orë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzistenca e menysë ditore</li> <li>• Ekzistenca e orarit të të ushqyerit</li> </ul>

<p>X.2.23 Qendra do të sigurojë të ushqyerit individual për fëmijët me nevoja të veçanta dietetike apo që nuk janë në gjendje për të ushqyer veten në mënyrë adekuate</p>	<p>Ekzistenca e rregulloreve të brendshme</p>
<p>X.2.24 Menytë e ndryshme për dreka dhe ushqime do të përgatiten për tërë javën. Menytë do të postohen çdo javë në një vend ku prindërit dhe vizitorët tjerë relevantë mund ti shohin ato</p>	<p>Ekzistenca e menysë</p>
<p>X.2.25 Fëmijët nuk duhet të privohen nga dreka ose ushqimi si një formë e dënimit disiplinor.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzistenca e menysë ditore</li> <li>• Ekzistenca e procedurave të ankimimit</li> </ul>

## Referencat

1. Applicative Research Solutions (ARS)- Raport i rishikimit afatmesëm të Projektit “Shërbimet me bazë në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara”- Përgatitur për Save the Children International, Zyra në Prishtinë/Kosovë, Tetor 2017
2. Save the Children International, Zyra në Prishtinë/Kosovë- Raporti I Progresit në Implementimit e projektit “Shërbimet me bazë në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara”- 2016
3. UNICEF- Analiza e Situatës fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë- 2017
4. MACP dhe Save the Children Kosovë- Krijimi I një mjedisi gjithpërfshirës dhe mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara në Evropën Lindorë- Fletushkë 2017
5. Save the Children International, Zyra në Prishtinë/Kosovë- Raporti për shpenzimet publike për fëmijët me aftësi të kufizuara- 2016
6. Save the Children International, Zyra në Prishtinë/Kosovë - Analizë e situatës: Konteksti ligjor dhe fiskal si dhe kapacitetet e ofruesve të shërbimeve sociale në Kosovë- 2018
7. KMOP- Korniza e Shërbimeve dhe Standardet Minimale të Cilësisë së Shërbimeve Sociale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara në Qendrat e Kujdesit Ditor- 2015
8. HandiKos Prishtinë- Manual pune: Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe të standardizuara qendrat e rehabilitimit të bazuar në bashkësi- 2018
9. HandiKos Ferizaj dhe HandiKos Gjakovë- Dokumentacioni i shërbimeve të ofruara për fëmijët me aftësi të kufizuara- 2016-2018
10. CDIP Bosnia- Job And Service Description For The Centres For The Development Of Inclusive Practices In Bihac And Cazin With A Description Of Activities, Staff And Mobile Expert Teams- 2016





SAVE THE CHILDREN IN KOSOVA/O

Str. Gazmend Zajmi, no 01

10000 Prishtine, Kosova/o

Phone: +383 (0) 38 23 26 91

Email: [scik@savethechildren.org](mailto:scik@savethechildren.org)

[www.kosovo.savethechildren.net](http://www.kosovo.savethechildren.net)

<https://www.facebook.com/savethechildreninkosova>